

KARTELË INFORMATIVE				
				AL012037
1. Emri i shërbimit	Regjistrim i aktit të vdekjes			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Ky shërbim i vlen qytetarit për të bërë të mundur çregjistrimin e personit nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, i cili shoqërohet me përditësimin e procedurave nga institucione të tjera			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Regjistrimi i aktit të vdekjes për të vërtetuar ligjërisht vdekjen e shtetasit dhe çregjistrimin nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile			
4. A jam përfitues?	Të gjithë shtetasit të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Nga lëshohet?	Vlefshmëria
	1	Raporti mjekësor	Mjeku	
	2	Çdo dokument i cili vërteton vdekjen e një personi dhe që lëshohet nga - drejtuesit e spitaleve - reparteve ushtarake - reparteve të burgjeve, reparteve të riedukimit, dhe të institucioneve të tjera kur vdekja ndodh në institucionet e tyre	Drejtuesit e spitaleve / reparteve ushtarake / të burgjeve / apo çdo Institucioni tjetër kur vdekja ndodh në Institucionet e tyre	
	3	Vendimi i gjykatës që shpall shtetasin të vdekur: -Kur personi ka vdekur në shtet të huaj, akti i vdekjes mbahet në shtetin e huaj -Në rast se personi varroset në shtet të huaj, certifikata nga akti i vdekjes legalizohet i noterizuar me vulë apostile, sillet në Shqipëri nga personi i familjes dhe më pas përkthehet në gjuhën shqipe dhe sillet pranë Zyrës së Gjendjes Civile (përkatëse) për çregjistrim -Në rastet e varrimit të personave për të cilët akti i vdekjes është lëshuar nga autoriteti i huaj, por varrimi do të kryhet në Shqipëri, specialisti i Zyrës së Gjendjes Civile plotëson manualisht një formular hard-copy (kopje fizike), i cili është i ngjashëm me lejen për varrim dhe autorizon varrimin e personit të vdekur. Ky formular plotësohet manualisht dhe nuk regjistrohet në sistem por arkivohet pranë Zyrës së Gjendjes Civile -Në rastet e personave me dy shtetësi që do të varroset në shtetin e huaj, personi përgjegjës duhet të paraqitet pranë Zyrës së Gjendjes Civile, bashkëlidhur me skedën e vdekjes. Personit përgjegjës i mbahet akti i vdekjes nga Zyra e Gjendjes Civile. Në shkëmbim personit përgjegjës i jepet certifikatë për dokument, certifikatë për Institutin e Sigurimeve Shoqërore, por jo certifikatë për shpenzime varrimi	Gjykata	
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse	Qyteti	Adresa	Orari
	Sporteli ADISA Zyrat e Gjendjes Civile	Sporteli ADISA Krujë, Kavajë dhe Gjirokastrë Në çdo qytet të Republikës së Shqipërisë	ADISA web: www.adisa.gov.al Në njësinë administrative në të cilën qytetari është i regjistruar	ADISA: E hënë - e premte, ora 08:00 - 15:00 DPGJC: E hënë - e premte, ora 08:00 - 16:00
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1 Ofrohet informacion mbi shërbimin	Niveli 2 Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Niveli 3 Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Niveli 4 Shërbimi ofrohet tërësisht online
				
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë	Tarifa shtesë	Mënyra e pagesës	
	Shërbim pa pagesë	Në rast se personi nuk çregjistrohet nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile brenda 10 ditëve, personi përgjegjës gjohet me një shumë prej 3 000 lekësh	Gjoha paguhet në sportelet e zyrës së gjendjes civile	
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	Menjëherë			
10. Çfarë përfitoj?	Çregjistrimin e personit të vdekur nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	Pa afat			
12. Ku e marr?	Në sportele 	Me postë 	E- albania 	Me e-mail 
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC)			
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	Kontakto në:		Orari	
	E- albania: e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacioni@adisa.gov.al DPGJC web: www.mb.gov.al/al/ministria/institucione-ne-varesi Call Center : 11800		Call Center: E Hënë - E Premte, ora 07:00-14:00 E shtunë, ora 07:00 - 14:00	
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në sportele 	Me postë 	Me internet 	Me e-mail 
	Në platformën "Shqipëria që duam" Linku: www.shqiperiaqeduam.al 			
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	• Ligji Nr. 9062, datë 08.05.2003, "Kodi i Familjes" i ndryshuar • Ligji Nr. 10 129, datë 11.05.2009, "Për Gjendjen Civile" i ndryshuar • VKM Nr. 332, datë 17.3.2010, "Për përcaktimin e formës, elementeve përbërëse, mënyrës së mbajtjes e afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile" i ndryshuar			

